



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.78/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Fejzullah Mustafa në cilësinë e menaxherit në shkollën “Kuvendi i Arbërit”, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

Më datën 29.04.2012 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK në të cilën theksohet se libri i identifikimit të votuesve nuk gjendet në hyrje të shkollës aty ku duhet

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lendes PZAP-i konstatoi se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë, apo ndonjë deklaratë si dëshmi, që do ta bënë të besueshme ekzistimin e shkëljes së tillë. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 78/2012 më datën 30.04.2012

Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha

